



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.333, datë 19.12.2022

PËR

“PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR TË FILLUAR NDAJ
MAGJISTRATIT _____ ME DETYRË, PROKURORE NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË _____”

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 145 në lidhje me nenin 126, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 184, germa “e” dhe 189, pika 1, germa “a” dhe pika 3, të ligjit Nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe nenin 66, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pezullimin e procedimit disiplinor nr. 251/31, datë 21.07.2020, të filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit _____ prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë _____ sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Ky pezullim ka efekt deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit _____, me vendim përfundimtar.
3. Ky vendim i njoftohet brenda afatit 5 ditor magjistratit _____ dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 19.12.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Goxhi



ANËTAR
Esmeralda Keshi



ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

